



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM
Nr.67, datë 13.04.2022

PËR MIRATIMIN E VEPRIMTARISË JASHTË FUNKSIONIT
PËR PROKURORIN ADNAN HOXHA

Në mbështetje të nenit 149/ç, të Kushtetutës të Republikës të Shqipërisë, të nenit 9, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të germës “a”, të pikës 1, të nenit 189, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, të nenit 8, të Rregullores së Këshillit të Lartë të Prokurorisë “Për veprimtaritë jashtë funksionit të prokurorëve”, , pasi u njoh me kërkesën me nr. 702 prot., datë 31.03.2022 dhe Relacionin e përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, i Administrimit dhe Buxhetit, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e veprimtarisë jashtë funksionit për prokurorin Adnan Hoxha, konkretisht qenien ekspert, sipas propozimit të bërë nga Qendra për Studime Ligjore dhe Sociale, në kuadër të projektit “Monitorimi i Spak-ut dhe Gjykatës Speciale: Ndërtimi i një rekordi të qëndrueshëm ndjekjesh penale dhe dënimesh”, për periudhën prill 2022- qershor 2022, por jo më shumë se dy orë në javë gjatë orarit të punës.
2. Të njoftohen për këtë vendim z. Adnan Hoxha dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.
4. U shpall në Tiranë, sot më datë 13.04.2022.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



KRYETAR
ALFRED BALLA

ANËTAR
SOKOL STOJANI

ANËTAR
BUJAR SHESHI

ZV/KRYETAR
TARTAR BAZAJ

ANËTAR
NURIHAN SEITI



ANËTAR
ELOIDA GOXHI

ANËTAR
ZEQIR HODA

ANËTAR
ESMERALDA KESHI

ANËTAR
LUDOVIK DODAJ

ANËTAR
MIRELA BOGDANI